REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr. 4062/1 Prot. Lushnje, më 13/05/2024

PROJEKT - VENDIM

NR. 49 DATË 13/05/2024

PËR NJË SHTESË NË VKB-NË NR 05 DATË 26/01/ 2024 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA, QË BANOJNË ME QIRA NË TREGUN E LIRË DHE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TA PËRBALLUAR VETË GJITHË VLERËN E QIRASË"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/2024 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga zyra e Strehimi dhe në zbatim të nenit 24, nenit 54 të ligjit Nr: 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social", kreu V neni 33, 34, 35, 38, dhe të VKM Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin" dhe të VKB Nr.90 datë 23.11.2023 "Mbi miratimin e sisitemit të pikëzimit për programin Subvencionimi i Qirasë "Këshilli Bashkiak:

PROPOZOJMË :

1. Të miratojë listën e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kan të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vleren e qirasë për periudhën Qershor - Dhjetor 2024, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Strehimit dhe Drejtoria e Financë- Buxhetit.
3. Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Drejtoria Shërbimit Social

Anila Cela

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

Kryetari i Bashkisë

Eriselda Sefa

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16të ligjit nr. 22/2018	Adresa	Përberja familjare	Struktura e apartamentit	Qiraja mes. e apart. në treg per strukturen qe i takon familjes	Të ardhurat familjare mujore	Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia
a	b	c	d	e	f	h	i	n
1	Anila Bari Balla	Divorcuar	"Xhevdet Nepravishta"	4	2+1	12,000	-	6,000
2	Jonida Zija Kasa	Divorcuar	"Loni Dhamo"	3	1+1	10,000	-	5,000
3	Mirjon Miter Prifti	PAK	"Skender Libohova"	3	1+1	10,000	-	5,000
4	Egnesa Bujar Kazanxhiu	Vajze-Nene	"Xhevdet Nepravishta"	2	1+1	10,000	-	5,000
5	Fadil Selman Shero	PAK	"Njësia Administrative Golem"	4	2+1	8,000	-	4,000

Drejtoria e Shërbimit Social

Anila Cela